

## **SPECIFIKIME TEKNIKE**

Skicimet, parametrat teknik etj:

1. Objektet që do të mirëmbahet impjanistika janë të gjithë ambjentet e Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësore Shkoder, Godina NJ.V.K.Sh, 4 (kater) Shtëpitë Mimoza; Qendra Komunitare; Ambjentet e Stomatologjisë, Spitali Psikiatrik dhe Laboratori Bakterologjik - Shkoder

Specifikimi i Materialeve: Materialet që do të përdoren do të jenë të reja në përputhje me standartet kombëtare e nderkombëtare të miratuara.

Përshkrimi i kerkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mirembajtje impjanistika e objekteve sa herë që do të njoftohet nga enti prokurues operator ekonomik duhet të përgjigjet në kryerjen e shërbimit brenda një kohe sa më të shkurter në përputhje me preventivin të hartuar nga specialisti i Nj.V.K.SH – Shkoder si dhe në zbatim të kontratës së lidhur me entin prokurues. Të zbatojë specifikimet teknike për të gjithë zërat e punimeve që do të jetë e domosdoshme për të kryer riparimet me cilesi sa më të mirë.

## **SHERBIMET DHE GRAFIKU I EGZEKUTIMIT**

Sherbimi që kërkohe:

Sherbimet që do të kryhen sipas një preventivi paraprak të hartuar nga specialisti i Nj.V.K.SH – Shkoder me të cilin do të fitohet tenderi i mirëmbajtjes impjanistikës ( Riparime H/Sanitare dhe Elektrike ) si dhe nevojave që do të dalin gjate punes së përditshme.

Zerat e punës, materialet dhe pjeset që janë përcaktuar në preventivin paraprak janë një parashikim i përafërt, dhe përdorimi i tyre do të varet nga difektet faktike që do të ndodhin.

Sherbimi do të kryhet menjëherë me marrjen e njoftimit brenda orarit zyrtar si dhe jashtë tij kur gjykohe e nevojshme, për ato shërbime që nuk presin pasi krijojnë çrregullime në aktivitetin e përditshem të NJ.V.K.SH – Shkoder. Kontraktuesi duhet të kryej shërbimin në një kohe sa më të shkurtër dhe në prani të përfaqesuesit të Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor - Shkoder.

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimi do të filloj që me nënshkrimin e kontratës deri me **20.12.2023**.

## KAPACITETI TEKNIK

Kapaciteti Teknik që kërkohet:

Kontraktuesi duhet të ketë një kapacitet teknik të mjaftueshëm për kryerjen e punës me cilësi të mirë dhe në kohën e duhur.

Makinerite e pajisjet që kërkohen:

NR	Lloji i makinerive	Njesia	Sasia
1	Kamion vetshkarkues kapacitet 2 ton	cope	1
2	Xhenerator	cope	1
3	Skele metalike	m <sup>2</sup>	300
4	Panele derrase,puntela metalike, fiksuesa metalike për skeleri, etj	cope	200
5	Saldatriçe monofaze ose 3 fazore	cope	1
6	Vegla pune, (vegla specialisti hidraulik,elektrik,vegla specialisti ndertimi, etj )		

## STAFI DREJTUES

Operatori ekonomik duhet të ketë një staf të kualifikuar për kryerjen e punimeve në të gjithë specialitetet e kerkuara ( ndertimore,elektrike,hidraulike etj.)

Stafi drejtues qe kerkohet:

1. Inxhinier ndertimit me licensë.	1	Punonjes
2. Inxhinier Elektrik	1	Punonjes
3. Specialist+punëtorë ndertimi.	2	Punonjes
4. Specialist ( elektrikist ).	2	Punonjes
5. Specialist ( hidraulik ).	3	Punonjes

Gjithsejt            9    Punonjës

## LIÇENSAT DHE KATEGORIT E FIRMES

Operatori ekonomik duhet të ketë licensën e ndertimit të firmes ku të jenë të përfshira keto kategori punimesh ndërtimore:

- 1. Niveli i klasifikimit te shoqerise te jete e klasit A**
- 2. Kategoria për Punime të përgjithshme ndërtimi.**
  - a) **NP-2 - A**      Punime civile dhe industriale;
  
- 3. Kategorite për Punime Speciale Ndërtimi**
  - a) **NS-2 - A**      Impjante hidro sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre;
  - c) **NS-14 - A**    Impjante të brendëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni,T.V, etj.

Për Nj.V.K.Sh. – Shkoder

Ing. Shkelzen Geci

Ek. Qamile Kakini

Tek. Shkelzen Vorfa